



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

PROJEKT-VENDIM

DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR KURIMIN E FËMIJËS ALTEA BAZE

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, për mbulimin e një pjesë të shpenzimeve për kurimin e fëmijës Altea Baze, Kryetari i Bashkisë

PROPOZON:

- 1- Dhënie e ndihmës financiare në vlerën 50.000 (pesedhjet mijë) lekë, për kurimin e fëmijës Altea Baze, familjes Fjorda Mustafallari.
- 2- Vlera prej 50.000 (pesedhjetë mijë) lekë, të transferohet nga artikulli 602, në artikullin 606, (Transferta për buxhete familjare dhe individët).

KRYETARI

ADRIATIK MEMA

ME URDHËR DHE NË MUNGESË

**NËNKRYETARI
ALTIN LAMCE**



Konfirmoi:
Drejtore Juridike
Rudina Lango



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

RELACION

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR SHTETASEN ALTEA BAZE BANOORE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇOROVODË, BASHKIA SKRAPAR

Spektori i Shërbimit Social bazuar në kërkesën e bërë nga shtetasja **Fjorda Mustafallari** më datë **29.04.2025**, si dhe në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 24, “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, pikal, bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë me *NR.5, datë 07.02.2025*, për buxhetin e Bashkisë Skrapar dhe institucionet në varësi të saj për vitin 2025 :

JU RELATOJ:

Familja e shtetases Fjorda Mustafallari me banim në qytetin e Çorovodës, Bashkia Skrapar, përbëhet prej 4 anëtarësh. Kryefamiljarja, dy djemtë dhe vajza.

Vajza e familjes prej disa kohesh ka shfaqur disa probleme shëndetësore, të cilat kanë nevojë që të ndiqen me mjekime dhe vizita të herë pas herëshme nga mjeku.

Familja trajtohet me ndihmë ekonomike dhe në kushte të vështira sociale dhe ekonomike. Të ardhurat që merr nga ndihma ekonomike nuk mjaftojnë për të përballuar jetesën dhe shpenzimet, për të rritur dhe shkolluar e vetme tre fëmijët si dhe për të marrë trajtimet mjekësore të vajzës.

E ndodhur në këto kushte të vështira sociale – ekonomike dhe në rrezik për shëndetin e vajzës, Bashkia Skrapar merr përsipër dhënie e ndihmës financiare në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak dhënie e ndihmës financiare për shtetasen Altea Baze.

Përgjegjëse e NE-së dhe PAK-së

Teuta Hysenbelliu

